



ANALIZA E ECURISË SË ÇMIMEVE TE SPECIT DHE KARROTËS NË TREGJE TË SHUMICËS NË VEND DHE RAJON PERIUDHA 25 QERSHOR – 25 KORRIK




Burim i çmimeve të Prishtinës: www.food-ks.org Rijekës: <http://www.tisup.mps.hr>



Çmimi FOB Prishtinë: Çmimi Mesatar – Transport/kg


Çmimi FOB Rijeka: Çmimi Mesatar – ((Transport+Zhdoganimi + Tarifa e Importit)/kg)




	Jan.	Shkur	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nentor	Dhjet
E				0.2	0.04	0.2	2.6	0.0	0.0	0.3	0.3	0.01
I	9.9	7.8	8.4	9.1	16.4	1.4	0.2	0.1	2.66	0.16	10.45	9.79

Ecuria e çmimit të specit kapi (të stërgjatur) në tregjet e Tiranës, Lushnjes, Prishtinës dhe Rijekës është paraqitur në grafikun I. Çmimi mesatar i specit kapi në tregun e Tiranës dhe Lushnjes për periudhën 25 Qershor-25 Korrik 2009 vlerësohet respektivisht në 33 lek/kg dhe 30 lek/kg. Ky produkt duke qenë se është në sezonin e vet, ka qenë prezent gjatë gjithë periudhës së observuar. Ashtu sikurse duket dhe nga grafiku, çmimi i specit në tregun e Tiranës ka pasur luhajtje më të larta ditore sesa në Lushnje, megjithëse të dyja tregjet dëshmojnë për një tendencë në rënie të çmimit të këtij produkti. Speci është shitur mesatarisht 26% më shtrenjtë në tregun e Tiranës, ku luhajtjet e kanë çuar çmimin disa herë më poshtë se në tregun e Lushnjes si p.sh gjatë periudhës 4-10 Korrik. Çmimi i specit gjatë javës së katërt të Qershorit në Tiranë është luhatur rreth vlerës 53 lek/kg, për të vijuar me një ulje në 38 lek/kg, 25 lek/kg dhe 21 lek/kg në javën pasardhëse, duke e marrë veten vetëm në javën e katërt të Korrikut me vlerën mesatare 23 lek/kg. Çmimi i shumicës së specit në tregun e Lushnjes ka shënuar rënie konstante gjatë gjithë periudhës dhe ka zbritur në mënyrë konstante nga 49 lek/kg në 43 lek/kg, në 23 lek/kg, në 14 lek/kg dhe 10 lek/kg. Çmimi në tregun e Prishtinës është luhatur rreth vlerës 64 lek/kg ose 2 herë më lartë se mesatarja në tregun e Lushnjes. Çmimi në tregun e Rijeka-s është luhatur rreth vlerës 213 lek/kg ose 7 herë më lartë sesa çmimi mesatar në Lushnje.

Grafiku 2 tregon çmimin maksimal FOB që mund të negociohet në tregjet jashtë vendit, përkatësisht në Rijeka dhe Prishtinë duke hequr nga çmimi i shumicës në këto destinacione (të dhëna në grafikun I), kostot e transportit, çdoganimit dhe tarifat e importit (tarifa e importit në Kosovë është 0% kurse në Kroaci 8% për periudhën e observuar). Ashtu sikurse duket qartë nga grafiku 2 avantazhi konkurrues që mbart speci në çmim preket shumë pak nga tarifat dhe transporti. Hapësira negociuese mbetet më e madhe në Kroaci me gjithë kostot më të larta për kg (afërsisht 17 lek/kg) sesa në Kosovë (rreth 6 lek/kg). Kështu çmimi FOB Rijeka, Kroaci është mesatarisht 9 herë më i lartë se çmimi në tregun e shumicës së Lushnjes, kurse çmimi FOB në Prishtinë vetëm rreth 1.9 herë më i lartë. Interesant është fakti se momenti më i mirë për të eksportuar specia kapi në Kroaci është intervali Janar Korrik, kur tarifa e importit është vetëm 8% në vend të 15% +21 €/100kg për pjesën tjetër të vitit. Diferencat në çmimet e shumicës midis tregjeve vendase dhe atyre të huaja, mungesa e specit të importit gjatë këtij sezoni, tendencat në rritje të eksporteve dhe në rënie të importeve (shih grafikun 3) vërtetojnë edhe njëherë avantazhet konkurruese që mbart ky produkt gjatë kësaj periudhe në nivel rajoni. Momenti më i suksesshëm për eksportin është muaji Korrik, gjë që duket qartë edhe në tabelë poshtë grafikut 3. Speci momentalisht eksportohet në rajon, Kosovë, Mal i Zi e Maqedoni ku avantazhet konkurruese të tij mund të kontribuojnë në ekspansionin e mëtejshëm në këto tregje gjatë të gjithë muajve të sezonit.




Burim i çmimeve të Prishtinës: www.food-ks.org Rijekës: <http://www.tisup.mps.hr>



Çmimi FOB Prishtinë: Çmimi Mesatar – Transport/kg

Çmimi FOB Rijeka: Çmimi Mesatar – ((Transport+Zhdoganimi + Tarifa e Importit)/kg)



Burimi: ACIT

Grafiku 4 tregon ecurinë e çmimit mesatar të karrotës në 4 tregje shumice në tre vende të rajonit, Shqipëri, Kosovë dhe Kroaci. Ndryshe nga produktet e tjera çmimi mesatar i karrotës në tregun e Tiranës është më i lirë se ai në tregun e Lushnjës, kjo lidhet me faktin se karrota, duke qenë produkt josezonal përballet në Tiranë me një kërkesë më të lartë konsumatore sesa në tregun e shumicës së Lushnjës. Ky i fundit nuk është treg primar për furnizimin me karrotë në Tiranë dhe shërben vetëm si treg lokal për këtë produkt. Çmimi i shumicës së karrotës është luhatur rreth vlerës mesatare 54 lek/kg dhe 50 lek/kg respektivisht në tregun e Lushnjës dhe Tiranës, kurse diferenca mesatare për të gjithë periudhën midis dy tregjeve është vetëm 1%. Kjo për shkak se çmimi i karrotës në Lushnje është luhatur pak mbi ose baraz me çmimin e tregut të shumicës në Tiranë për periudhën 25 Qershor – 13 Korrik dhe nën vlerën e këtij produkti gjatë periudhës 13-25 Korrik. Çmimi i karrotës në Kosovë është luhatur rreth vlerës 88 lek/kg, ndërsa në Rijeka 102 lek/kg.

Grafiku 5 tregon çmimin maksimal FOB që mund të negociohet në tregjet jashtë vendit, përkatësisht në Rijeka dhe Prishtinë duke hequr kostot e transportit, çdoganimit dhe tarifave të importit (tarifa e importit në Kosovë është 0%, kurse në Kroaci 8% për karrotën gjatë gjithë vitit). Çmimi FOB Lushnja me destinacion tregun e shumicës së Prishtinës është rreth 57% më i lartë se çmimi në tregun e shumicës së Lushnjës gjatë periudhës së observuar. Çmimi FOB Lushnja me destinacion tregun e shumicës së Rijekës është rreth 60% më i lartë se çmimi në tregun e Lushnjës. Avantazhet konkurruese të tregtimit të karrotës në Rijeka dhe Prishtinë në krahasim me tregun e Lushnjës janë të përafërta, nëse bazohemi te faktori çmim. Nëse e kombinojmë ecurinë e çmimit me ecurinë e importeve dhe eksporteve mund të themi se prodhimi vendas përbën pjesën më të rëndësishme të konsumit vendas të këtij produkti, pasi importi i tij ndonjë herë është në vlera minimale, duke rezultuar në balancë pozitive tregtare në vitin 2008. Megjithatë eksportet dëshmojnë trend rritjeje gjatë vitit 2008 (siç duket në Graf. 6) dhe avantazhet konkurruese në nivel çmimi të këtij produkti, në të dyja tregjet, janë të dukshme. Elementë të tjerë ndikues të tillë si: barrierat jotarifore të produktit (standardet e cilësisë, parakushtet e paketimit) që vijnë herë si pjesë e preferencës konsumatore në tregje të tjera e herë si norma të zbatuara nga shteti duhet të merren parasysh në vendimarrje. Nëse krahasojmë dy produktet e observuara në këtë analizë, karrotën dhe specin, ato gëzojnë epërsi në çmim (FOB ose çmim shumice) në nivel rajoni, speci gëzon avantazhe konkurruese më të larta në çmim e shanse më të mira të suksesit në tregjet rajonale në këtë aspekt, sesa karrota.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

KONKURRUESHMËRIA
E BUJQËSISË SHQIPTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Bujqësisë
Ushqimit dhe
Mbrotjtjes së Konsumatorit